

URDHËR
Nr. 54, datë 1.3.2018

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 22, 28, dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2 të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, z. Pëllumb Abeshi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.
 2. Kompetencat e deleguara të titullarit të autoritetit kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31.12.2018
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Drejtori i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit, z. Pëllumb Abeshi.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi